


E DREJTA PËR INFORMIM

“Të përkushtuar për garantimin e besueshmërisë në aksesin në informacionin publik”, zhvillohet mbledhja e ExCo të ICIC

Nën drejtimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zotit Besnik Dervishi, në cilësinë e Presidentit të Komitetit Ekzekutiv (ExCo) të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), u zhvillua takimi i parë për vitin 2026 i këtij forumi drejtues të organizatës.

Në fjalën e tij hapëse, Komisioneri Dervishi vlerësoi maksimalisht kontributin e çdo autoriteti anëtar për fuqizimin e rolit të ICIC, ndërsa paraqiti një përmbledhje të rendit të ditës. Po ashtu, ai e vuri theksin te përgatitjet për Konferencën vjetore që do të mbahet në muajin shtator 2026 në Sierra Leone dhe rëndësinë që ka tematika e propozuar, e cila do t'i orientojë diskutimet rreth integritetit të informacionit.





Komisioneri Dervishi deklaroi se: “në mbarë botën po përballemi me sfida të tilla, si disinformimi, rënia e besimit të publikut dhe zhvillimi i shpejtë digjital. Si Komisionerë të Informimit kemi përgjegjësinë të garantojmë që informacioni publik të jetë i saktë, i besueshëm dhe i aksesueshëm”.

Në vijim të kësaj mbledhjeje, Zyra e Komisionerit, në cilësinë e Sekretariatit të ICIC, prezantoi para anëtarëve të ExCo proceset dhe dokumentet e punës të realizuara gjatë periudhës mes dy mbledhjeve të këtij forumi. Një pikë tjetër e rëndësishme e trajtuar nga të pranishmit në këtë takim ishte edhe njohja me me Raportin final të Konferencës së kaluar, të zhvilluar në Berlin të Gjermanisë, dokument për të cilin u ra dakord që të publikohet në faqen zyrtare në internet të ICIC ([Raporti](#)).

Zhvillohet takimi i tretë i Komitetit të Planifikimit për Konferencën e ICIC 2026

Komiteti i Planifikimit për Konferencën 2026 të ICIC zhvilloi online takimin e tretë, në kuadër të përgatitjeve për këtë ngjarje. Zyra e Komisionerit e moderoi mbledhjen së bashku me Komisionerin Shaw nga Sierra Leone, vend në të cilin do të mbahet ky aktivitet.

Në cilësinë e autoritetit organizator, Komisioneri Shaw paraqiti një sërë tematikash për t'u marrë në konsideratë, si panele gjatë Konferencës së ardhshme. Anëtarët pjesëmarrës në takim kontribuuan me diskutime dhe sugjerime të ndryshme, duke u fokusuar, veçanërisht, në përcaktimin e temës kryesore.



Gjithashtu, përfaqësues të UNESCO theksuan se programi i ditës së parë do t'i dedikohet Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim - IDUAI 2026, ndërsa ceremonia e hapjes do të organizohet në mënyrë të përbashkët nga ICIC dhe UNESCO. Konferenca do të zhvillohet përgjatë dy ditëve të hapura me sesione plenare dhe paralele, ndërsa po shqyrtohet mundësia e organizimit të aktiviteteve shtesë edhe në ditën e tretë të saj.

Në ditët në vijim pritet të bëhet njoftimi dhe shpallja zyrtare e datave të këtij aktiviteti madhor për të gjithë anëtarësinë e ICIC. Takimi i radhës i Komitetit të Planifikimit parashikohet të zhvillohet në javën e tretë të muajit mars.


Transparenca e bashkive, prezantohet raporti i monitorimit të Faktoje.al

Transparenca dhe akses i qytetarëve në informacion në bashkitë e vendit ka patur rritje, por kjo rritje nuk shkon paralel me mbajtjen e premtimeve elektorale nga kryetarët e bashkive. Këto janë ndër gjetjet kryesore të projektit “40 Premtime, 10 Bashki”, i realizuar nga Faktoje.al për vitin 2025 dhe i mbështetur nga organizata jofitimprurëse amerikane *National Endowment for Democracy*.

Rezultatet e projektit u bënë publike në një tryezë ku morën pjesë ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Ervin Demo, përfaqësues të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, nga agjenci ndërkombëtare, të institucioneve të pavaruara, medias dhe shoqërisë civile. Edhe gjatë prezantimit të gjetjeve të monitorimit, u theksua rritja e transparencës në nivel vendor, duke vlerësuar njëkohësisht edhe rolin dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për nxitjen dhe forcimin e saj.



Përmirësimi i transparencës ndihmon në ndërtimin e besimit të qytetarëve dhe përmbushja e premtimeve mbetet sfidë, çështjet të rëndësishme të trajtuara edhe në diskutimet e zhvilluara në këtë takim. Bashkitë e monitoruara për vitin 2025 ishin ato të Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Kavajës, Fierit, Vlorës, Korçës, Sarandës, Lezhës dhe Shkodrës. Monitorimi u bazua në 16 indikatorë të transparencës dhe konsultimit publik dhe tregoi diferenca mes bashkive që e kanë institucionalizuar tashmë transparencën dhe atyre që e trajtojnë atë si detyrim formal.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:



Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit shkurt 2026 ka dhënë një vendim në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Sipas [vendimit nr. 7, datë 24.02.2026](#), Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Korporatës së Investimeve Shqiptare (në vijim “autoriteti publik” dhe/ose “KISH”) me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës së datës 13.11.2025, depozituar në adresën elektronike grei.flamuraj@aicorporation.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me: 1) kopje të buxhetit të Korporatës për vitet 2020-2025; 2) një kopje të buxhetit të zbatuar të Korporatës për vitet 2020-2024 me zërat specifike për shpenzimet e kryera, bazuar në zërat specifike të buxhetit; 3) nga data e themelimit të Korporatës e deri më sot, kush kanë qenë anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrjes së saj dhe sa ka qenë gjatësia e pozicionit të tyre?; 4) A ka pasur dhe nëse po, sa ka qenë shpërblimi për angazhimin e këtyre anëtarëve? Po kërkoj shumat specifike të paguara nga buxheti i Korporatës për çdo individ dhe në total në bazë vjetore, jo vetëm shumën e parashikuar në listpagesën e shpërblimeve për postin; 5) Nga data e themelimit të Korporatës e deri më sot, kush kanë qenë anëtarët e Bordit Këshillimor të saj dhe sa ka qenë gjatësia e pozicionit të tyre? dhe 6) A ka pasur dhe nëse po, sa ka qenë shpërblimi për angazhimin e këtyre anëtarëve? Po kërkoj shumat specifike të paguara nga buxheti i Korporatës për çdo individ dhe në total në bazë vjetore, jo vetëm shumën e parashikuar në listpagesën e shpërblimeve për postin.

Autoriteti publik, në rrugë elektronike, ka kthyer përgjigje duke referuar linkun e [Programit të Transparencës](#) në faqen zyrtare të tij. Ankuesi, pas kësaj përgjigje, me pretendimin se nuk i është vendosur në dispozicion informacioni i plotë sipas pikave të kërkesës, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e KISH për dhënie të dokumentacionit të kërkuar. Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 LDI.

Zyra e Komisionerit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” ka kërkuar nga autoriteti publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion.

KISH, në formë shkresore, ka kthyer përgjigje duke rivlerësuar kërkesën për informacion dhe ka sqaruar ndër të tjera, se “informacioni dhe të dhënat mbi buxhetin e Korporatës së Investimeve Shqiptare ndër vite gjendet në faqen zyrtare të QKB, rubrika “Kërko për subjekt në regjistrin tregtar” dhe tek ekstrakti historik i Korporatës mund të shkarkohen të gjitha pasqyrat financiare, raportet e auditit, raportet e ecurisë së veprimtarisë së drejtimit dhe pagesave që nga data e themelimit. Në lidhje me anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, lista e plotë me emrat e anëtarëve që nga themelimi i Korporatës e deri më sot, kohëzgjatja e emërimit të tyre si dhe të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur me anëtarët ndër vite gjendet në faqen zyrtare të QKB, rubrika “Kërko për subjekt në regjistrin tregtar” ku mund të shkarkohet dhe ekstrakti historik i Korporatës, në linkun <https://qkb.gov.al/kerko-per-subjekt/>. Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit janë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” si dhe Statutit të Korporatës së Investimeve Shqiptare, të cilat i gjeni në linkun <https://www.aicorporation.al/sq/rreth-nesh/ligjet-dhe-rregulloret>.

Në vijim të procedurës, ankuesi ka kërkuar vazhdimin e ankimit duke saktësuar objektin e kërimit konkretisht për pikat 3, 4, 5 dhe 6 të kërkesës fillestare për informacion. Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 LDI dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015, Komisioneri vlerësoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore, e cila u mbajt në datën e caktuar me pjesëmarrjen e ankuesit dhe përfaqësuesve të KISH, koordinatorit për të drejtën e informimit dhe specialistit ligjor. Gjatë saj, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore, duke argumentuar se kërkesa e tij për informacion vijon të jetë e papërmbushur nga autoriteti publik. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e KISH rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur, duke e konsideruar të përmbushur qëllimin e LDI. Në përfundim të seancës dëgjimore, përfaqësuesit e autoritetit publik konfirmuan se ishin personat përgjegjës që kishin trajtuar ankesën, dhe iu la një afat i arsyeshëm të rishikonin qëndrimin e mbajtur. Në vijim, KISH në rrugë elektronike ka kthyer përgjigje duke vendosur në dispozicion ekstraktin historik të datës 19.01.2026, lëshuar nga QKB. Pas kësaj përgjigje, ankuesi në rrugë elektronike ka kërkuar vijimin e ankimit, për pikat 4 dhe 6 të kërkesës fillestare për informacion.

Pas konsultimit të legjislacioneve të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga autoriteti publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procedurës administrative, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga KISH nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 2 të tij parashikohet, se: “... c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike”. Nga verifikimi i kryer në QKB në ekstraktin historik të Regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, rezulton se KISH është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, që ka si objekt të veprimtarisë “nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit me potencial komercial në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit, etj”. Në këtë kuptim, KISH është autoritet publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në pikën 1 të nenit 1 përcakton, se: “ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Në lidhje me pretendimin e autoritetit publik, se: shpërblimet e anëtarëve të Këshillit janë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 71/2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, si dhe Statutit të saj, të cilat i gjeni në linkun <https://www.aicorporation.al/sq/rreth-nesh/ligjet-dhe-rregulloret>, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi në ligjin material dhe në Statutin e Korporatës përcaktohet në parim mënyra e shpërblimit të anëtarëve dhe nuk përcaktohet shuma e shpërblimit, sipas objektit të kërkesës për informacion. Bazuar në ligjin nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjit nr. 9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit”, çdo subjekt tregtar apo person fizik a juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë QKB ka detyrimin që në ekstraktin historik të deklarojë dhe përditësojë të dhënat e tij, të përmbushë detyrimet ligjore, tatimore dhe financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, etj. Ndërkohë, informacioni i kërkuar është informacion specifik dhe nuk evidentohet nga ekstrakti historik në Regjistrin Tregtar të KISH, të vendosur në dispozicion për ankuesin nga autoriteti publik. Po ashtu, LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës të subjektit të interesuar.

Në kategorinë e parë përfshihen ato informacione të cilat publikohen dhe vendosen në dispozicion nga autoriteti publik pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti (sipas pikës 1 të nenit 7 të LDI), ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë të informacionit, pasi kemi të bëjmë me një kërkesë për informim të depozituar pranë KISH, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI, legjislacioni i cili rregullon aksesin në informacionin publik për çdo person të interesuar. Në nenin 17 të tij, gjithashtu, përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Rezulton, se autoriteti publik në asnjë rast, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar, nuk ka argumentuar apo të bënte një analizë të mirëfilltë në lidhje me mosdhënien e informacionit sipas kësaj dispozite. Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 dhe duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI. Në çdo rast, pagat dhe shpërblimet e funksionarëve publikë konsiderohen informacion publik, pasi lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e fondeve publike dhe ushtrimin e funksioneve publike. Vendosja në dispozicion të kërkuësve dhe/ose publikimi i këtyre të dhënave është i nevojshëm për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien e administratës ndaj qytetarëve. Të ardhurat që burojnë nga funksioni publik, përfshirë pagën dhe shpërblimet, nuk konsiderohen të dhëna personale dhe nuk gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, Komisioneri konstaton, se koordinatori për të drejtën e informimit dhe specialisti ligjor në KISH janë personat përgjegjës të cilat nuk kanë përmbushur detyrimin për kthimin e përgjigjes së kërkesës fillestare për informacion, rrjedhimisht kanë refuzuar dhënien e informacionit. Për këto arsye, bazuar në shkronjën a) të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 18; pikën 4 të nenit 19; pikat 1 dhe 2 të nenit 21; nenin 22; shkronjat b) dhe c) të pikës 5 të nenit 24 të LDI dhe shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Komisioneri ka vendosur: 1) pranimin e ankesës, 2) urdhërimin e autoritetit publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit për pikat 4 dhe 6 të kërkesës fillestare për informacion; 3) dënimin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe specialistit ligjor, në cilësinë e personave përgjegjës, secili me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.